VENDIM
Nr.78, datë 17.9.2003

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN "PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË EKZEKUTIMIT TË DETYRIMEVE MBI SHUMAT E LLOGARIVE NË BANKA" MIRATUAR ME VENDIMIN E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË BANKËS SË SHQIPËRISË NR.43, DATË 11.6.2003

Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, pasi shqyrtoi propozimin e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike, në bazë të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë",

VENDOSI:

1. Në nenin 6 me titull "Procedura për pezullimin e ekzekutimit të kërkesës/urdhrit", të udhëzimit "Për mënyrën e zbatimit të ekzekutimit të detyrimeve mbi shumat e llogarive në banka", të miratojë ndryshimet si vijojnë:

a) Pika 6.1. bëhet: "Pezullimi i kërkesës/urdhrit për vënien e sekuestros bëhet vetëm kundrejt paraqitjes së vendimit të gjykatës për pezullimin e ekzekutimit të vendimit, në përputhje me kriteret e caktuara në nenet 206, 471, 479 dhe 615 të Kodit të Procedurës Civile.".

b) Në pikat 6.2 dhe 6.3 shprehja "pezullimin e gjykimit" zëvendësohet me shprehjen "pezullimin e ekzekutimit të vendimit".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani